



STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË OPERATORIT TË BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

2025-2027

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje	3
1.1 Roli dhe misioni i Operatorit të Blerjeve të Përqendruara	3
1.2 Kuadri ligjor	3
1.3 Qëllimi dhe metologjia	5
2. Analizë e situatës aktuale	7
3. Analiza SWOT	8
4. Vizioni dhe objektivat strategjikë	9
4.1 Vizioni.....	9
4.2 Konteksti.....	9
4.3 Objektivat Strategjike	10
7. Rezultatet e pritshme	17
8. Marketingu dhe Marrëdhëniet me Publikun	18
9. Indikatorët e Performancës dhe monitorimi i zbatimit.....	19
10. Plani i Zbatimit.....	21
11. Metodologjia e monitorimit dhe zbatimit	24

1. Hyrje

1.1 Roli dhe misioni i Operatorit të Blerjeve të Përqendruara

Operatori i Blerjeve të Përqendruara është një shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror, krijuar nga Këshilli i Ministrave me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sh.a, për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë”.

Misioni i Shoqërisë është ofrimi i shërbimeve të prokurimeve për autoritetet/entet kontraktore, në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës në fuqi. Shoqëria aksionare organizohet dhe funksionon, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare, është ministria përgjegjëse për ekonominë. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionin ka themeluar dhe regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit Shoqërinë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sh.a në datë 1 Mars 2024, me NIPT M41501042N.

1.2 Kuadri ligjor

Operatori i Blerjeve të Përqendruara ushtron veprimtarinë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

- Ligji nr. 850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar.
- Ligji nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 87/2019, datë 18.12.2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.
- Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar
- Ligji nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”.

- Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Ligji nr. 120/2014, datë 18.09.2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Ligji nr. 9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës”.
- Ligji nr.10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 9723, datë 03.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.
- Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.
- Ligji nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.
- VKM Nr. 531, datë 07.09.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sh.a, për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë”, e ndryshuar
- VKM Nr. 768, datë 13.12.2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.531, datë 7.9.2023, të këshillit të ministrave, “Për krijimin e Shoqërisë Aksionare Shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqendruara”, Sh.A., për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë”, të ndryshuar"
- VKM Nr.813 datë 28.12.2023 për disa ndryshime në vendimin nr. 531, datë 7.9.2023, të këshillit të ministrave, “për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha, për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë”
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar
- VKM nr. 678, datë 03.10.2007 “Për një shtesë në vendimin nr. 271, datë 09.05.1998 “Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore”.
- VKM nr. 570, datë 03.10.2018 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”.
- VKM nr. 107, datë 09.02.2011 “Për përbërjen, rregullat e organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Sigurisë dhe shëndetit në punë”.
- VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së banimit, brenda vendit” i ndryshuar.
- VKM-në nr. 245, datë 17.4.2024 “Për përcaktimin dhe përlllogaritjen e tarifës, për kryerjen e veprimtarive ndihmëse, për prokurimin publik nga shoqëria aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha”
- VKM nr. 436, datë 26.6.2024 “Për krijimin, organizimin e funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”
- Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- Statuti i Shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sh.a.
- Akti i Themelimit të Shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sh.a.

1.3 Qëllimi dhe metologjia

Qëllimi

Dokumenti i Planit Strategjik të Zhvillimit nga OBP paraqet vizionin e OBP në perputhje me vizionin zhvillimit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Qeverisë Shqiptare.

Qëllimi i këtij dokumenti është **hartimi i një platforme strategjike** e cila jep bazat për një zhvillim të qëndrueshëm për të gjithë strukturat e OBP duke siguruar një zhvillim sa më të balancuar ekonomik dhe social. Kjo strategji synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha veprimtaritë e OBP në fushën e prokurimeve të përqendruara në një vizion të përbashkët dhe koherent me MEKI dhe qeverinë Shqiptare të fokusuar në disa fusha prioritare.

Si e tillë synon:

1. Përmirësimin në vazhdimësi të veprimtarisë.
2. Identifikimin e veprimtarive kryesore dhe planifikimin mjeteve të nevojshme.
3. Të ndihmojë bashkëpunimin me të gjithë aktorët relevant për përmbushjen e objektivave për OBP.

Bazuar në këtë dokument zhvillohen planet operuese për secilin vit, ku përcaktohen objektivat vjetore prioritare, aktivitetet konkrete dhe mjetet/burimet përkatëse.

Metodologjia

Hartimi i strategjisë ka nisur duke u konsultuar fillimisht me bazën ligjore ku përcaktohen funksionet dhe detyrat e OBP të përshkruara në kapitullin e hyrjes.

Paralelisht Strategjia është mbështetur dhe në **Strategjinë e Zhvillimit të Qëndrueshëm** të qeverisë Shqiptare kryesisht në Axhenden 2030 për zhvillimin e qëndrueshëm si dhe në **Strategjinë Kombëtare për Prokurimin Publik 2024 – 2030** ku për shkak të misionit të OBP në fokus qëndror ka për mision rolin e veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor për blerje të përqendruara.

Në mënyrë paralele është kryer mbledhja e të dhënave nga të gjithë strukturat e OBP dhe analiza e situatës aktuale. Janë evidentuar pikat e forta dhe pikat e dobëta për çdo sektor, të cilat janë përmbledhur shkurtimisht në formën e analizave SWOT. Në bazë të gjetjeve të analizës janë nxjerrë dhe objektivat kryesore të strategjisë për 3 vjeçarën e ardhshme, të zbërthyera në aktivitetet e detajuara së bashku me indikatorët përkatës, të cilët do të ndihmojnë në thjeshtimin por dhe në efikasitetin e procesit të monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë.

Objektivat kryesore synojnë të adresojnë çështjet prioritare dhe janë planifikuar në mënyrë të tillë që të kryhen të bashkërenduara duke përdorur të ardhurat e OBP në mënyrë sa më efikente për të siguruar qëndrueshmërinë në zhvillim e sipër.

Për sa i përket analizës financiare, ajo është bazuar në zhvillimet e vitit të fundit si vit i krijimit të OBP dhe në projektimin e programit ekonomik 2025 duke përcaktuar trendin e të ardhurave dhe shpenzimeve për efekt të projeksionit në 3-vjeçarin e ardhshëm. Kjo ka ndihmuar për të kuptuar në mënyrë të përafërt si do të vijojë ky trend përgjatë 3-vjeçarit të ardhshëm duke u bazuar në situatën aktuale dhe objektivat e vendosura nga strategjia.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe procesit të monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë si edhe strukturave përgjegjëse për këtë detyrë, në mënyrë që të kemi koordinim dhe fokusim në përmbushjen e objektivave strategjike të përcaktuara në këtë dokument.



Parimet

Parimet të cilat kanë udhëhequr procesin e hartimit të Strategjisë, janë edhe parimet mbi të cilat MEKI synon të arrijë në të ardhmen. Më konkretisht:

- ✓ Zhvillimi i qëndrueshëm: Për të patur një zhvillim të qëndrueshëm duhet gjithmone përfshirja në politikat e MEKI, e cila përfshin politikat dhe strategjite ndërkombëtare rajonale dhe sektoriale. Shfrytëzimi i burimeve të bëhet nëpërmjet një planifikimi të integruar për të arritur zhvillim ekonomik dhe social që garanton qëndrueshmëri në kohë dhe jetëgjatësi.
- ✓ Subsidiariteti: Ushtrimi i përgjegjësisë duhet t'iu takojë më tepër autoriteteve të cilat janë më pranë qytetarëve ku dhe impakti është më i madh.
- ✓ Bashkërendimi: Kjo strategji ndjek objektivat dhe parimet thelbësore të zhvillimit të përcaktuara në dokumentet strategjike të qeverisë shqiptare. Në të njëjtën mënyrë, është përpjekur të jetë në harmoni me interesat e biznesit dhe shoqërisë civile duke promovuar forma të ndryshme bashkëpunimi për një zhvillim të përbashkët të qëndrueshëm.
- ✓ Llogaridhënia dhe Transparenca: Ky dokument është hartuar duke u bazuar në parimin e transparencës dhe përgjegjësisë. Të gjitha qëllimet dhe objektivat strategjike janë përkthyer në aktivitete specifike të matshme nëpërmjet treguesve të performancës, gjithashtu të përcaktuara, duke i bërë këto objektiva lehtësisht të monitorueshme.
- ✓ Gjithëpërfshirja: Kjo nënkupton, krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë stafin për zhvillim të qëndrueshëm të përbashkët.
- ✓ Fleksibiliteti: Objektivat strategjike dhe aktivitetet janë hartuar duke marrë parasysh disa skenarë zhvillimi për të arritur përmbushjen më optimale të objektivave përgjatë kësaj periudhe në mënyrë të tillë që të lejojë hapësirat e nevojshme për t'iu përshtatur kontekstit.

2. Analizë e situatës aktuale

Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka nisur ushtrimin e veprimtarisë tregëtare në 25 Prill 2024, praktikisht nënkuptohet që prej kësaj date ka nisur procesimi i kërkesave për prokurim të dërguara nga autoritetet kontraktore pranë OBP. Gjatë harkut kohor 25.04.2024 – 31.12.2024 OBP ka procesuar 338 kërkesa për prokurim, nga të cilat ka faturuar 322 kërkesa të 141 institucioneve klientë të OBP.



OBP me krijimin si Institucion ka strukturuar njësitë e operimit, shpenzimet relevante dhe gjeneruar burimin e të ardhurave për funksionimin e saj. Në këtë kuadër ka rregulluar dhe sanksionuar marrëdhëniet brenda institucionit dhe ato me AK dhe OE nëpërmjet hartimit dhe miratimit të rregulloreve të funksionimit konkretisht:

- Rregullore e Brendshme e Shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” miratuar me Vendim të Këshillit Mbikqyrës nr.06, datë 26.07.2024;
- Kodi i Sjelljes dhe Etikës për Punonjësit e Blerjeve të Përqendruara miratuar me Vendim të Këshillit Mbikqyrës nr.06, datë 26.07.2024;
- Rregullore e Komunikimit Institucional mes OBP Sh.A dhe Autoriteteve Kontraktore me nr._551 datë 13.02.2025;
- Programi i Zhvillimit Ekonomik 2025 – 2028 miratuar me Vendimin e Asamblesë Nr. 1171 datë 30.12.2024;
- Strukturimit të pasqyrave financiare sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi për këtë qëllim dhe auditimi i tyre në bazë të raportit të Audituesit të Pavarur sipas kërkesave të shoqërive tregtare.

3. Analiza SWOT

Analiza SWOT është një metodë strategjike që përdoret për të vlerësuar Forcat (Strengths), Dobësitë (Weaknesses), Mundësitë (Opportunities) dhe Kërcënimet (Threats) e një organizate, projekti ose iniciative. Kjo analizë ndihmon në marrjen e vendimeve më të strukturuar dhe në zhvillimin e strategjive të suksesshme.

Pikat e forta të OBP

- ✓ Efikasitet dhe profesionalizëm – Ekspertizë e specializuar në prokurimet publike, duke reduktuar shkeljet administrative/penale dhe rritur mirëpërdorimin e fondeve publike.
- ✓ Transparencë dhe reduktim i korrupsionit – Procedura të standardizuara dhe qasje e centralizuar që zvogëlon hapësirën për ndërhyrje të paligjshme.
- ✓ Harmonizim i praktikave të prokurimit – Përdorimi i procedurave të njëjta për të gjitha institucionet pjesëmarrëse rrit standardizimin dhe cilësinë.
- ✓ Përdorim më i mirë i fondeve publike – Efikasitet më i madh në përdorimin e buxhetit të shtetit përmes prokurimit të përqendruar, duke rritur kursimin.

Dobësitë e OBP

- Vonesa në planifikim– Institucionet publike detajojnë me vonesë buxhetin, rrjedhimisht dërgojnë me vonesë kërkesat për prokurim pranë OBP, duke shkaktuar problematikë në planifikimin e procedurave vjetore, duke marrë në konsideratë se procedurat e prokurimit kryhen të qendëruara.
- Periodiciteti i procedurave – kërkesat e institucioneve ndodh të konsistojnë në marrëveshje kuadër 4 vjeçare, duke shtyrë në kohë periodicitetin e dërgimit të kërkesës për prokurim, duke ndikuar në qendrueshmërinë financiare të OBP.

Mundësitë e OBP

- ❖ Digjitalizimi dhe inovacioni – Përdorimi i platformave elektronike mund të rrisë efikasitetin dhe transparencën.
- ❖ Bashkëpunimi me institucione të ngjashme në BE – Zbatimi i standardeve evropiane dhe praktikave më të mira, mund të rrisë efektivitetin e një organi qendror blerës.
- ❖ Zgjerimi i fushës së veprimit – OBP mund të zgjerojë shërbimet që ofron një organ qendror blerës, objektet e prokurimit, klientët si dhe tipologjinë e institucioneve klientë (për shembull autoritetet ente, që funksionojnë me të ardhurat e tyre e jo me buxhetin e shtetit).

Kërcënimet e OBP

- ✖ Ndryshimet në legjislacion – Aktet ligjore/nënligjore mund të ndryshojnë, duke sjellë një ndikim të drejtpërdrejtë tek funksionimi i OBP.
- ✖ Kriza ekonomike ose inflacioni – Ndryshimet në treg mund të ndikojnë në të ardhurat e pritshme.
- ✖ Vonesat në vendimmarrjen nga ana e KPP – Vonesa e shqyrtimit të ankimeve nga KPP mund të krijojë vonesa në nënshkrimin e kontratave nga ana e AK-ve, duke rrezikuar edhe djegie të fondeve buxhetore të planifikuara për t'u zbatuar.
- ✖ Mungesa e burimeve të qëndrueshme financiare - Megjithëse OBP ushtron veprimtarinë bazuar në vetë-financim, mbulimi i kostove për investime në modernizim mund të kërkojë burime shtesë financimi.
- ✖ Pjesëmarrja e kufizuar e operatorëve ekonomikë- në disa objekte prokurimi të caktuara paraqitet pjesëmarrje e kufizuar e operatorëve ekonomikë.

4. Vizioni dhe objektivat strategjike

4.1 Vizioni

OBP të jetë një organ qendror blerës ekselence në prokurimin e përqendruar, duke rritur efektivitetin e shpenzimeve publike përmes inovacionit, transparencës dhe standardeve të larta.

4.2 Konteksti

Kjo strategji, është përpiluar duke qenë në linjë me **Strategjinë Kombëtare për Prokurimin publik 2024–2030**, konkretisht me objektivin specifik 1.3 “Përmirësimi i blerjes së përqendruar” dhe “Axhenda 2030 për zhvillim të qëndrueshëm” në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 63, datë 12.05.2017 për zbatimin e axhendës së OKB 2030 për zhvillimin e qëndrueshëm, konkretisht me

objektivin 12.7 “Promovimi i praktikave të prokurimit publik të qëndrueshme në përputhje me politikat dhe prioritetet kombëtare”

4.3 Objektivat Strategjike

1. Përmirësimi i efencës së blerjeve të përqendruara dhe sigurimi i qëndrueshmërisë

Për arritjen e këtij objektivi, parashikohen aktivitetet e mëposhtme:

1.1. Hartimi i analizës për identifikimin e kategorive të mallrave dhe shërbimeve që mund të përfshihen në blerjet e përqendruara.

Një grup i posaçëm pune do të analizojë objektet e prokurimit të cilat nuk janë të përfshira në VKM-në nr. 531, sa i përket mallrave, shërbime apo punëve që ende vijojnë të prokurohen nga institucionet dhe jo nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

1.2. Organizimi i serisë së takimeve bashkëpunuese me institucionet e fushës (AKU, Universiteti Politeknik, inspektoriate etj).

Ky aktivitet konsiston në rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, duke marrë në konsideratë se për objekte të caktuara prokurimi, nevojitet komunikim me institucione përgjegjëse të fushës, konkretisht për vënien në dispozicion të ekspertëve të fushës në prokurim, në unifikim të katalogjeve, si dhe sa i përket dokumentacioneve të caktuara për të cilat stafit të OBP-së i nevojitet konsultim.

1.3. Unifikimi i objekteve të prokurimit në katalogje.

Aktualisht, janë 6 katalogje të unifikuara për objektet: Blerje ushqimesh, Kancelari, Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim. Parashikohet zgjerimi i objekteve të unifikuara në specifikime teknike dhe çmime, përmes miratimit të katalogjeve për përdorim nga autoritetet kliente të OBP dhe jo vetëm.

1.4. Përfshirja e kritereve sociale dhe mjedisore në procedurat e prokurimit.

Prokurimi i Gjelbër, i njohur me fokus në uljen e ndikimit mjedisor dhe promovimin e qëndrueshmërisë gjatë gjithë ciklit jetësor. Ai përfshin marrjen në konsideratë të faktorëve si: Ndikimi mjedisor; Prioriteti i produkteve dhe shërbimeve që janë efikase në energji, të bëra nga materiale të riciklueshme ose të rinovueshme dhe që kanë një gjurmë më të ulët karboni: Përgjegjësia sociale; Sigurimi që furnizuesit të ndjekin praktikat etike të punës dhe të kontribuojnë pozitivisht në komunitetet e tyre.

2. Digjitalizimi dhe inovacioni në blerjet e përqendruara

Për arritjen e këtij objektivi, parashikohen aktivitetet e mëposhtme:

2.1 Konceptimi i formatit të databazës së të dhënave kryesore dhe përditësimi nga çdo drejtori.

Formati do të jetë një përmbledhje e të dhënave kryesore për çdo kërkesë për prokurim që dërgohet pranë OBP, që nga momenti fillestar deri në përfundimin e procedurës së prokurimit.

Të dhënat kryesore që do të përmbaje kjo databazë konsistojnë: Autoriteti Kontraktor, Ministria ku varet, Objekti i prokurimit, Kategoria (Mall, Sherbim, Pune), Nr prot AK Date AK, Nr prot OBP Date OBP, Praktika e saktë (Po/Jo), Data e prerjes së faturës, Afati i likuidimit, Data e pagesës, Data e shpalljes së procedurës, Nr Ref, Lloji i procedurës, Ankesa DST (Po/Jo), E perqendruar (Po/Jo), Data e hapjes së tenderit, Data e Vlerësimit Përfundimtar, Ankesa për Vlerësim (Po/Jo), Data e MK/Njoftim fituesi përfundimtar.

2.2 Përditësimi i AlbZone.

AlbZone është një platformë e brendshme komunikimi midis OBP dhe autoriteteve kontraktore kliente të OBP. Përmes kësaj platforme online, autoritetet mund të dërgojnë kërkesat për prokurim për objektet e prokurimit të cilat kanë specifikime teknike dhe çmime të unifikuara. Duke qenë se teknologjia është gjithmonë në përmirësim, Sektori i IT do të mundësojë përditësimin e platformës me “feature” të nevojshëm për të lehtësuar komunikimin dhe punën e autoriteteve për sa i përket dërgimit të kërkesave për prokurim.

2.3 Zhvillimi i E-AlbZone

Platforma E-AlbZone do të jetë një platformë e cila do të përdoret nga autoritetet kontraktore kliente të OBP pasi të jetë finalizuar procedura e prokurimit nga organi qendror blerës. Qëllimi kryesor do të jetë porositja e mallrave objekt prokurimi direkt pranë operatorit ekonomik të shpallur fitues. Në këtë mënyrë do të reduktohet koha si dhe do të rritet ndjeshëm monitorimi në kohë reale i ecurisë së zbatimit të marrëveshjes kuadër/kontratës së kërkuar për t’u prokuruar pranë OBP.

2.4 Zhvillimi i platformës së gjenerimit automatik të DST-së.

Zhvillimi i platformës së gjenerimit automatik të DST-së, konsiston në automatizimin e procesit të konceptimit të një DST-je, duke mundësuar reduktim të punës manuale dhe rritje të efikasitetit. Nëse aktualisht një DST mund të kërkojë mesatarisht disa orë, me krijimin e këtij softueri do të mund të krijohet për jo më shumë se 20 min. Softueri automatikisht krijon dhe menaxhon dokumentet, duke ulur marzhin e gabimeve njerëzore.

3. Qendrueshmëria financiare

Për arritjen e këtij objektivi, parashikohen aktivitetet e mëposhtme:

3.1 Krijimi i planit të veprimit për zgjerim të objekteve të prokurimit

Bazuar në analizën që do të zhvillohet në aktivitetin e parë të objektivit nr 1. “Përmirësimi i efikasitetit të blerjeve të përqendruara dhe sigurimi i qëndrueshmërisë”, do të hartohet plani i veprimit me masat konkrete sa i përket objekteve të prokurimit të synuara për t’u shtuar në veprimtarinë e OBP.

3.2 Analiza e klientëve potencial për zgjerim

Një burim tjetër i rëndësishëm financiar janë klientët potencial që mund të zgjerohen në gamën e klientëve të OBP. Konkretisht në këtë listë mund të përfshihen autoritetet që funksionojnë me të ardhurat e veta, shoqëritë aksionare shtetërore, universitetet etj. Kjo analizë do të përcaktojë strategjinë e nevojshme që të rritur qasjen pranë këtyre autoriteteve në mënyrë që të mundësohet kryerja e procedurave të tyre të prokurimit pranë OBP.

3.3 Hartimi i një plani të qëndrueshmërisë financiare 3-vjeçare

Ky aktivitet ka në fokus zhvillimin e një plani strategjik financiar për një periudhë 3-vjeçare, me synimin për të siguruar qëndrueshmërinë ekonomike dhe operacionale të OBP në afat të mesëm. Planin do të përfshijë një analizë të burimeve aktuale dhe potenciale të gjenerimit të të ardhurave, parashikime të detajuara të të ardhurave dhe shpenzimeve, identifikimin e risqeve financiare dhe masave për menaxhimin e tyre, si dhe strategji për diversifikimin e të ardhurave dhe rritjen e autonomisë financiare.

Ky proces përfshin:

- Vlerësimin e performancës financiare ekzistuese;
- Identifikimin e burimeve të reja të gjenerimit të të ardhurave
- Përcaktimin e objektivave financiare afatmesme;
- Hartimin e buxheteve vjetore projeksionale;
- Zhvillimin e mekanizmave për monitorim dhe raportim financiar periodik.

Planin do të shërbejë si një mjet udhëzues për menaxhimin financiar strategjik dhe do të ndihmojë në forcimin e qëndrueshmërisë dhe transparencës financiare të OBP.

4. Rritja e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë

Për arritjen e këtij objekti, parashikohen aktivitetet e mëposhtme:

4.1 Hartimi i programit të aktiviteteve dhe fushatave informuese për operatorët ekonomikë mbi procedurat dhe mundësitë që ofron OBP

Ky aktivitet synon të zhvillojë një program të strukturuar informimi dhe ndërgjegjësimi për operatorët ekonomikë lidhur me procedurat, përfitimet dhe mundësitë që ofron OBP. Programi do të përfshijë hartimin e një kalendari vjetor me aktivitete informuese, trajnime dhe fushata komunikimi, të cilat synojnë të rrisin njohuritë dhe angazhimin e bizneseve në proceset që lidhen me OBP-në.

Elementet kyçe të programit do të përfshijnë:

- Identifikimin e target-grupeve të operatorëve ekonomikë;
- Hartimin e përmbajtjes informuese në formate të përshtatshme (prezantime, broshura, video, materiale digjitale);
- Planifikimin e eventeve informuese (workshop-e, tryeza, forume) në nivel lokal dhe kombëtar;
- Përcaktimin e kanaleve dhe mjeteve të komunikimit (media sociale, platforma online, media tradicionale);

Ky program do të ndihmojë në fuqizimin e transparencës, përfshirjes dhe bashkëpunimit midis OBP-së dhe komunitetit të biznesit, duke kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes dhe përfitimit nga mundësitë që ofron struktura.

4.2 Bashkëpunime me Dhomat e Tregëtisë, Drejtorinë e Tatimeve dhe shoqatat e biznesit për të promovuar OBP

Ky aktivitet ka për qëllim krijimin dhe forcimin e bashkëpunimit institucional dhe sektorial me aktorë kyç të fushës së biznesit, siç janë Dhoma e Tregëtisë, Drejtoria e Tatimeve dhe shoqatat e biznesit, me synim promovimin e OBP-së. Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve, synohet rritja e ndërgjegjësimit dhe informimit të operatorëve ekonomikë mbi rolin, shërbimet dhe mundësitë që ofron OBP, si dhe nxitja e pjesëmarrjes së tyre aktive.

Aktiviteti përfshin:

- Vendosjen e marrëveshjeve bashkëpunimi me institucionet dhe organizatat partnere;
- Organizimin e eventeve të përbashkëta informuese dhe promovuese (forume, panaire, tryeza diskutimi);
- Shkëmbimin e informacionit dhe shpërndarjen e materialeve informuese përmes rrjeteve të partnerëve;
- Koordinimin e fushatave të komunikimit dhe advokimit;
- Nxitjen e përfshirjes së partnerëve në aktivitetet e OBP dhe anasjelltas.

Ky bashkëpunim ndërinstitucional synon të zgjerojë ndikimin e OBP-së në komunitetin e biznesit, të forcojë besimin dhe transparencën, si dhe të krijojë një rrjet të qëndrueshëm për mbështetjen e operatorëve ekonomikë.

4.3 Krijimi i mekanizmave për mbledhjen e sugjerimeve dhe feedback-ut nga operatorët ekonomikë.

Ky aktivitet synon të vendosë mekanizma të qartë, të qëndrueshëm dhe të aksesueshëm për mbledhjen sistematike të sugjerimeve, komenteve dhe feedback-ut nga operatorët ekonomikë në lidhje me funksionimin, shërbimet dhe procedurat e prokurimit të OBP-së. Qëllimi është të sigurohet një komunikim dykahësh i vazhdueshëm dhe të nxiten përmirësime të bazuara në nevojat dhe përvojat reale të bizneseve.

Mekanizmat e parashikuar përfshijnë:

- Krijimin e një seksioni të dedikuar në faqen ekzistuese të internetit për mbledhjen e feedback-ut;
- Organizimin e anketave periodike për vlerësimin e kënaqësisë dhe nevojave të operatorëve ekonomikë;
- Mbajtjen e takimeve konsultative dhe dëgjësive me përfaqësues të bizneseve;
- Përcaktimin e një procedure të qartë për analizimin dhe adresimin e feedback-ut të marrë.

Zbatimi i këtij aktiviteti do të ndihmojë në rritjen e transparencës, përmirësimin e shërbimeve, si dhe në ndërtimin e një marrëdhënieje më të fortë dhe më të besueshme midis OBP-së dhe komunitetit të operatorëve ekonomikë.

5. Rritja e kapaciteteve të stafit dhe profesionalizimi i prokurimit publik

Për arritjen e këtij objekti, parashikohen aktivitetet e mëposhtme:

5.1 Hartimi dhe zbatimi i një programi të trajnimeve dhe ngritjeve të kapaciteteve për stafin e OBP.

Ky aktivitet ka për qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale dhe teknike të stafit të OBP-së përmes një programi të strukturuar trajnimesh dhe zhvillimi të vazhdueshëm. Programi do të synojë rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve, përmirësimin e njohurive mbi praktikatat më të mira, si dhe zhvillimin e aftësive menaxheriale, komunikuese dhe digjitale të stafit.

Hapat kryesorë të këtij aktiviteti përfshijnë:

- Identifikimin e nevojave për trajnim dhe analiza e boshllëqeve në kapacitete;
- Hartimin e një programi të detajuar trajnimesh afatshkurtër dhe afatmesëm;
- Përfshirjen e tematikave të tilla si: procedurat administrative, menaxhimi i projekteve, transparenca dhe llogaridhënia, teknologjia dhe komunikimi me publikun;
- Angazhimin e ekspertëve dhe institucioneve të specializuara për ofrimin e trajnimeve;
- Monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të trajnimeve në performancën e stafit.

Zbatimi i këtij programi synon të garantojë një staf të kualifikuar, të përgatitur për të përmbushur misionin e OBP-së me profesionalizëm dhe në përputhje me standardet bashkëkohore të administrimit dhe shërbimit ndaj publikut.

5.2 Organizimi i shkëmbimeve të përvojave me institucione homologe ndërkombëtare

Ky aktivitet synon të nxisë zhvillimin profesional të stafit të OBP-së dhe përmirësimin e praktikave të punës përmes organizimit të shkëmbimeve të përvojave me institucione homologe ndërkombëtare. Nëpërmjet vizitave studimore, takimeve bilaterale dhe pjesëmarrjes në forume apo trajnime ndërkombëtare, synohet të merren njohuri mbi modelet e suksesshme të funksionimit, teknologjitë e përdorura, praktikat përfshirëse dhe mënyrat inovative të bashkëpunimit me sektorin privat.

Ky aktivitet do të përfshijë:

- Identifikimin e institucioneve partnere ndërkombëtare me role dhe funksione të ngjashme me OBP-në;
- Krijimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe planifikimin e vizitave të ndërsjella;
- Organizimin e vizitave studimore dhe trajnimeve jashtë vendit për stafin e përzgjedhur;
- Dokumentimin dhe shpërndarjen e përvojave dhe praktikave të mira brenda institucionit;
- Përdorimin e mësimave të nxjerra për përmirësimin e proceseve dhe shërbimeve të OBP-së.

Ky aktivitet do të kontribuojë në ndërkombëtarizimin e OBP-së, në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe në përafrimin me standardet dhe praktikat më të avancuara evropiane e ndërkombëtare.

5.3 Krijimi i një platforme të brendshme për kazuset e prokurimit të përqendruar.

Ky aktivitet ka për qëllim krijimin e një platforme të brendshme digjitale për dokumentimin, analizimin dhe shkëmbimin e rasteve praktike (kazuseve) që lidhen me prokurimin e përqendruar. Platforma do të shërbejë si një mjet i brendshëm referimi dhe mësimi për stafin e OBP-së, duke mbledhur eksperiencat konkrete, sfidat, zgjidhjet dhe mësimet e nxjerra nga procedurat e realizuara.

Përmbajtja dhe funksionaliteti i platformës do të përfshijë:

- Regjistrimin sistematik të kazuseve sipas llojit të prokurimit, sektorit, problematikave të hasura dhe zgjidhjeve të zbatuara;
- Strukturimin e informacionit në mënyrë që të jetë lehtësisht i kërkueshëm dhe i përdorshëm për qëllime trajnimi dhe përmirësimi të punës;
- Integrimin e opsioneve për komente dhe analiza të brendshme nga stafi;

- Përdorimin e platformës si burim për standardizimin e praktikave dhe identifikimin e modeleve të suksesshme;
- Sigurimin e ruajtjes dhe përditësimit të vazhdueshëm të përmbajtjes nga një njësi përgjegjëse.

Kjo platformë do të ndihmojë në ndërtimin e një memorie institucionale, rritjen e kapaciteteve të brendshme, përmirësimin e proceseve të punës dhe garantimin e një qasjeje më të unifikuar dhe të bazuar në përvojë në realizimin e prokurimeve të përqendruara.

6. Monitorimi dhe raportimi efektiv i performancës

Për arritjen e këtij objekti, parashikohen aktivitetet e mëposhtme:

6.1 Krijimi i mekanizmave të auditimit të brendshëm për sigurimin e përputhshmërisë me standardet dhe rregulloret.

Ky aktivitet synon krijimin dhe funksionalizimin e mekanizmave të auditimit të brendshëm për të siguruar që veprimtaria e OBP-së zhvillohet në përputhje me standardet ligjore, rregulloret përkatëse dhe praktikën e mira të qeverisjes. Auditimi i brendshëm do të shërbejë si një instrument për rritjen e transparencës, integritetit dhe efikasitetit të brendshëm institucional.

Elementët kryesorë të këtij aktiviteti përfshijnë:

- Krijimin e një funksioni për auditimin e brendshëm, përfshirë përcaktimin e rolit, përgjegjësi dhe metodologjisë së punës;
- Përcaktimin e fushëveprimit të auditimit (financiar, operacional, procedural, përputhshmërie, etj.);
- Hartimin e një plani vjetor auditimi dhe përcaktimin e prioritetëve në bazë të riskut;
- Zhvillimin e procedurave për ndjekjen dhe adresimin e gjetjeve të auditimit;

6.2 Publikimi i raporteve periodike mbi efektivitetin dhe transparencën e blerjeve të përqendruara.

Ky aktivitet synon të rrisë transparencën, llogaridhënien dhe besueshmërinë e procesit të blerjeve të përqendruara, përmes hartimit dhe publikimit të raporteve periodike që analizojnë performancën, rezultatet dhe përputhshmërinë me rregulloret dhe objektivat institucionale. Raportet do të ofrojnë një pasqyrë të qartë për palët e interesit mbi mënyrën e realizimit të prokurimeve, kursimet e arritura, sfidat e hasura dhe masat e marra për përmirësim.

Përmbajtja e raporteve do të përfshijë:

- Të dhëna statistikore mbi prokurimet e realizuara: numri, vlera, kategoritë dhe sektorët përkatës;
- Vlerësime të kursimeve financiare;
- Analiza të indikatorëve të performancës (efikasiteti, koha e realizimit, konkurrueshmëria, përputhshmëria me procedurat ligjore);

Zbatimi i këtij aktiviteti kontribuon në forcimin e qeverisjes së mirë, rritjen e besimit publik në sistemin e blerjeve të përqendruara dhe promovimin e një kulture transparence dhe përgjegjshmërie në menaxhimin e fondeve publike.

6.3 Përdorimi i treguesve të performancës për përmirësimin e politikave dhe strategjive të prokurimit.

Ky aktivitet ka për qëllim vendosjen dhe përdorimin sistematik të treguesve të performancës (Key Performance Indicators – KPIs) për të matur, analizuar dhe përmirësuar vazhdimisht politikën dhe strategjitë e prokurimit të përqendruar. Përdorimi i këtyre treguesve do të mundësojë një vlerësim objektiv të funksionimit të sistemit të prokurimit, duke nxitur vendimmarrjen e bazuar në evidencë dhe orientimin drejt rezultateve konkrete.

Të dhënat e mbledhura përmes këtyre indikatorëve do të analizohen rregullisht dhe do të shërbejnë për:

- Përmirësimin e proceseve dhe procedurave të prokurimit;
- Hartimin ose përditësimin e politikave të reja në fushën e blerjeve të përqendruara;
- Përcaktimin e objektivave të matshme për periudhat e ardhshme;
- Rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në nivel strategjik.

Ky aktivitet ndihmon në krijimin e një sistemi të prokurimit më të efektshëm, më të përgjegjshëm dhe të orientuar drejt cilësisë dhe rezultateve të prekshme.

7. Rezultatet e pritshme

Aktivitetet e mësipërme, do të kontribuojnë në arritjen e rezultateve të mëposhtme:

- ✓ Identifikimi i objekteve të prokurimit me potencial për blerje të përqendruara.
- ✓ Rritja e efikasitetit në prokurim.
- ✓ Harmonizimi i praktikave të prokurimit ndërmjet institucioneve publike.
- ✓ Rritja e koordinimit ndërinstitucional.
- ✓ Përcaktimi i standardeve dhe kritereve të përbashkëta për prokurimet e përqendruara.
- ✓ Lehtësimi i shkëmbimit të informacionit dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve.

- ✓ Rritja e numrit të katalogjeve me specifikime teknike dhe çmime të unifikuara
- ✓ Krijimi i një databaze të centralizuar për menaxhimin e të dhënave.
- ✓ Rritja e transparencës dhe aksesit në informacion.
- ✓ Lehtësimi i vendimmarrjes mbi bazën e të dhënave të sakta dhe të përditësuara.
- ✓ Përmirësimi i funksionalitetit dhe saktësisë së të dhënave.
- ✓ Reduktimi i kohës për përgatitjen e dokumenteve standarde të tenderimit.
- ✓ Identifikimi i institucioneve dhe entiteteve që mund të përfitojnë nga blerjet e përqendruara.
- ✓ Sigurimi i stabilitetit financiar dhe optimizimi i burimeve financiare.
- ✓ Rritja e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në prokurimet publike.
- ✓ Lehtësimi i aksesit në informacion për proceset e tenderimit
- ✓ Rritja e ndërveprimit me komunitetin e biznesit.
- ✓ Rritja e transparencës dhe besimit në proceset e prokurimit.
- ✓ Përmirësimi i njohurive dhe aftësive të stafit për menaxhimin e prokurimeve.
- ✓ Zhvillimi i kapaciteteve për të aplikuar praktikat më të mira ndërkombëtare.
- ✓ Rritja e efikasitetit përmes ndarjes së eksperiencave dhe inovacioneve.
- ✓ Optimizimi i proceseve në bazë të analizave të performancës.

8. Marketingu dhe Marrëdhëniet me Publikun

Strategjia e marketingut dhe komunikimit të OBP përfshin një qasje transparente dhe gjithëpërfshirëse për të angazhuar klientët dhe partnerët nëpërmjet:

- ❖ Platforma digjitale: Përditësimi i informacioneve dhe shërbimeve përmes faqes zyrtare të OBP (www.obp.al), portalit të prokurimit (APP) dhe rrjeteve sociale (instagram, Facebook, X, LinkedIn).
- ❖ Evente dhe trajnime: Organizimi i seminareve dhe trajnimeve për institucionet publike dhe operatorët ekonomikë për të kuptuar proceset e prokurimit dhe për të përmirësuar pjesëmarrjen në tendera.
- ❖ Transparenca dhe raportimi: Publikimi i raporteve të rregullta mbi performancën dhe ndikimin e OBP në optimizimin e prokurimeve publike.
- ❖ Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare: Prezantimi i OBP si një model suksesi dhe shkëmbimi i eksperiencave me institucione të tjera ndërkombëtare.

➤ Platforma online dhe web-faqja zyrtare:

- Publikimi i informacioneve mbi procedurat e prokurimit dhe mundësitë e bashkëpunimit.
- Përditësimi i statistikave të publikuara në website, në kohë reale.

➤ Raporte dhe publikime:

- Buletine mbi prezantimin e punës vjetore të OBP;
- Raporte vjetore mbi kursimet dhe përfitimet e realizuara nga OBP.

➤ **Komunikimi me mediat dhe publikun**

- Organizimi i eventeve për të prezantuar rezultatet dhe strategjitë e OBP.
- Intervista dhe artikuj mbi sukseset dhe efektivitetin e OBP.

➤ **Trajnime dhe evente të dedikuara**

- Organizimi i trajnimeve nga institucione ndërkombëtare për të rritur kapacitetet e profesionalistëve në OBP;
- Organizimi i sesioneve informuese për institucionet publike mbi proceset e prokurimit të përqendruar, ndërgjegjësimi mbi transparencën dhe kursimet në buxhetin publik përmes OBP.

9. Indikatorët e Performancës dhe monitorimi i zbatimit

Ky komponent ka për qëllim vendosjen e një sistemi të qartë dhe të qëndrueshëm për matjen e progresit dhe vlerësimin e efektivitetit të veprimtarive të ndërmarra, përmes përcaktimit të **indikatorëve kyç të performancës (KPIs)** dhe mekanizmave të **monitorimit të zbatimit**.

Indikatorët e performancës do të përdoren për të matur:

- Arritjen e objektivave të planifikuara;
- Cilësinë dhe efikasitetin e zbatimit të aktiviteteve;
- Ndikimin real në përmirësimin e sistemit të prokurimeve të përqendruara;
- Niveli i përfshirjes së aktorëve dhe reagimi i tyre ndaj ndërhyrjeve të realizuara.

Në kuadër të këtij procesi, do të ndërtohen:

- **Tregues të matshëm, të qartë dhe të krahasueshëm**, të lidhur drejtpërdrejt me objektivat specifike të planit të veprimit;
- **Mekanizma monitorimi periodik**, përmes raporteve të brendshme, takimeve të vlerësimit dhe analizës së të dhënave;
- **Procedura për mbledhjen, analizën dhe raportimin e të dhënave**, për të ndjekur progresin në kohë reale dhe për të identifikuar nevojat për ndërhyrje korrigjuese;
- **Sistemi i përgjegjësisë**, ku çdo njësi apo individ ka rol të përcaktuar për mbledhjen dhe raportimin e indikatorëve përkatës.

Kjo qasje ndihmon në ndërtimin e një strukture menaxheriale të bazuar në rezultate dhe transparencë, duke mundësuar që vendimmarrja dhe planifikimi i ardhshëm të mbështeten në evidencë konkrete dhe të matshme.

Indikatorët kyç të performancës (KPIs)

1. Numri i klientëve unikë
2. Numri i kërkesave për prokurim të shpallura
3. Numri i kërkesave të procedurave
4. Numri i procedurave të shpallura
5. Numri i procedurave të ndara sipas mallra, shërbime, punë
6. Numri i procedurave ku janë përdorur kriteret sociale
7. Numri i procedurave ku janë përdorur kriteret e gjelbra
8. Numri i të punësuarve përmes procedurave ku janë përdorur kriteret sociale
9. Koha e procesimit të kërkesave për prokurim
10. Koha e kryerjes së një tenderi – nga shpallja deri te firmosja e kontratës
11. Përqindja e procedurave të anulhuara
12. Përqindja e procedurave për të cilat ka ankesa
13. Numri i ankesave
14. Koha e shqyrtimit të ankesave
15. Kursimi i arritur në raport me fondin limit – në përqindje absolute, në përqindje mesatare, në vlerë absolute lekë
16. Numri i procedurave me vetëm një ofertues
17. Numri mesatar i operatorëve ekonomik konkurues
18. Numri total i operatorëve ekonomik unik, konkurues
19. Numri i rasteve kur AK humbet nevojën pas kryerjes së procedurës së prokurimit
20. Numri i përdoruesve të AlbZone
21. Numri i kërkesave të dërguara përmes AlbZone
22. Numri i objekteve të prokurimit të unifikuara në katalogje
23. Numri i katalogjeve të rishikuara
24. Numri i artikujve të unifikuar në specifikime teknike dhe çmime
25. Shitjet

Mekanizmat e raportimit dhe vlerësimit të progresit.

Indikatorët e mësipërm do të maten në mënyrë periodike përmes mekanizmave të raportimit si më poshtë:

- ✓ Raportet Gjashtëmujore

Raportet gjashtëmujore do të përmbajnë një përmbledhje të progresit sipas objektivave strategjike, analizë të indikatorëve kyç të performancës (KPIs) në raport me pritshmëritë si dhe problematikat e hasura.

✓ Raportet Vjetore

Raportet vjetore do të përmbajnë një vlerësim të detajuar të arritjeve gjatë vitit, analiza të objektivave fillestare dhe rezultateve të pritshme. Gjithashtu do të përmbajnë rekomandime për përmirësime në vitin pasues.

10. Plani i Zbatimit

Ky plan shërben si udhërrëfyes për realizimin efektiv dhe të koordinuar të të gjitha aktiviteteve të parashikuara për realizimin e objektivave strategjike.

Objektivat	2025		2026		2027		Struktura përgjegjëse
1.Përmirësimi i efencës së blerjeve të përqendruara dhe sigurimi i qëndrueshmërisë.	6M1	6M2	6M1	6M2	6M1	6M2	
1.1. Hartimi i analizës për identifikimin e kategorive të mallrave dhe shërbimeve që mund të përfshihen në blerjet e përqendruara.							Spektori i Tregtisë dhe Projekteve
1.2 Organizimi i serisë së takimeve bashkëpunuese me institucionet e fushës (AKU, Universiteti Politeknik, inspektoriate etj)							Drejtoria e Standarteve dhe Tregëtisë Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
1.3 Unifikimi i objekteve të prokurimit në katalogje							Spektori i Standartizimit dhe Unifikimit
1.4 Përfshirja e kriterëve sociale dhe mjedisore në procedurat e prokurimit.							Drejtoria Teknike
2.Digjitalizimi dhe inovacioni në blerjet e përqendruara							
2.1 Konceptimi i formatit të databazës së të dhënave kryesore dhe përditësimi nga çdo drejtori							Kabineti
2.2 Përditësimi i AlbZone							Spektori i IT
2.3 Zhvillimi i E-AlbZone							Spektori i IT
2.4 Zhvillimi i platformës së gjenerimit automatik të DST-së							Spektori i IT
3.Qëndrueshmëria financiare							

3.1 Krijimi i planit të veprimit për zgjerim të objekteve të prokurimit							Drejtoria Teknike Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse Sektori i Tregëtisë dhe Projekteve
3.2 Analiza e klientëve potencial për zgjerim							Sektori i Tregëtisë dhe Projekteve
3.3 Hartimi i një plani të qëndrueshmërisë financiare 3-vjeçare							Sektori i Financës
4.Rritja e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë							
4.1 Hartimi i programit të aktiviteteve dhe fushatave informuese për operatorët ekonomikë mbi procedurat dhe mundësitë që ofron OBP							Drejtoria e Standarteve dhe Tregëtisë Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
4.2 Bashkëpunime me Dhomat e Tregëtisë, Drejtorinë e Tatimeve dhe shoqatat e biznesit për të promovuar OBP							Drejtoria e Standarteve dhe Tregëtisë Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
4.3 Krijimi i mekanizmave për mbledhjen e sugjerimeve dhe feedback-ut nga operatorët ekonomikë.							Drejtoria Teknike Sektori IT
5. Rritja e kapaciteteve të stafit dhe profesionalizimi i prokurimit publik							
5.1 Hartimi dhe zbatimi i një programi të trajnimeve dhe ngritjeve të kapaciteteve për stafin e OBP							Sektori i Burimeve Njerëzore
5.2 Organizimi i shkëmbimeve të përvojave me institucione homologe ndërkombëtare.							Të gjitha drejtoritë dhe Kabineti

5.3 Krijimi i një platforme të brendshme për kazuset e prokurimit të përqendruar							Drejtoria Teknike Njësia e Shqyrtimit të Ankesave Drejtoria e Vlerësimit të Ofertave Sektori IT
6.Monitorimi dhe raportimi efektiv i performances							
6.1 Krijimi i mekanizmave të auditimit të brendshëm për sigurimin e përputhshmërisë me standardet dhe rregulloret.							Sektori i Burimeve Mbështetëse
6.2 Publikimi i raporteve periodike mbi efektivitetin dhe transparencën e blerjeve të përqendruara.							Të gjitha drejtoritë
6.3 Përdorimi i treguesve të performancës për përmirësimin e politikave dhe strategjive të prokurimit.							Të gjitha drejtoritë

- Burimet financiare dhe mbështetja buxhetore për zbatimin e strategjisë.

Ky dokument strategjik është projektuar duke u mbështetur totalisht në të ardhurat që realizon OBP dhe që do të rrit vit pas viti në rreth 5% shtesë e argumentuar kjo me parashikimet e programeve ekonomike vjetore 2024, 2025 dhe projeksionet relevante për tre vitet e arshshme. Një aspekt tjetër që është konsideruar në ndërtimin e strategjisë është dhe menaxhimi sa më efektiv i shpenzimeve me tendencë ulje të moderuar të tyre.

- Partneritetet

OBP synon të rrisë gamën e partneriteteve më së shumti në përfitime përsa i përket rritjes së kapaciteteve profesionale dhe përthithjes së praktikave më të mira si Brenda ashtu dhe jashtë vendit me institucione homologe. Në të njëjtën kohë në vizionin e OBP është konsideruar qasja e këndvështrimitit sit ë AK ashtu dhe të OE në treg si partner për të bërë më të mirën e mundshme në realizimin e misionit dhe arritjen në masën më të mirë të mundshme të objektivave të OBP.

11. Metodologjia e monitorimit dhe zbatimit

Për ndërtimin e strategjisë ka punuar një grup pune i krijuar me Urdhrin e Administratorit nr. 355, datë 24.01.2025, ndryshuar me Urdhrin nr. 355/1, datë 03.03.2025 ku në përbërje të grupit të punës janë stafi drejtues vendimmarrës i cili do të luajë rolin e grupit të menaxhimit të strategjisë 2025-2027.

Baza e vlerësimit të shkallës periodike të realizimit të objektivave do të mbështetet në vlerësimin e aktiviteteve relevante të koordinuara dhe me realizimin e programit ekonomik nëpërmjet matjes së tyre me indikatorët e përcaktuar në këtë strategji. Vlerësimi do të kryhet periodikisht sipas planit të veprimtarisë së çdo strukture, përmbledhja e realizimit të objektivave do të kryhet individualisht nga Drejtoritë/Sektorët cdo gjatë muaj kurse analiza e realizimit të objektivave dhe vlerësimi e raportimi do të kryhen me bazë vejtore.

Strukturat mbartin detyrimin e vlerësimit periodic dhe raportimit jo formal tek grupi i menaxhimit dhe ky i fundit tek Administratori. Strukturat janë të lira të propozojnë tek grupi i menaxhimit rishikim periodic të objektivave në sensing e përmirësimit të vazhdueshëm të tyre. Përgjithësisht objektivat janë shoqëruar me indikatorë të matshëm por ka dhe raste ku vlerësimi do të mbështetet në arritjet e dukshme objektive dhe subjektive.